

VENDIM
Nr. 852, datë 21.10.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR
SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

2. Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “b”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

3. Në listën e shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në shkronjën “c”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E
OKB-së”)**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZA-
TËN AL-QAIDA**

a) Lista e shtuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”**;

1. AQSA; MAHMOOD,
2. NASSER; AHMED; MUTHANA,
3. OMAR; ALI; HUSSAIN,
4. SALLY-ANNE; FRANCES; JONES,
5. BOUBAKER; BEN HABIB; BEN AL-HAKIM,
6. PETER; CHERIF,
7. MAXIME; HAUCHARD,
8. AMRU; AL-ABSI,
9. MU’TASSIM; YAHYA; ‘ALI; AL-RUMAYSH,
10. TARAD; MOHAMMAD; ALJARBA,
11. LAVDRIM; MUHAXHERI,
12. ASEEL; MUTHANA,
13. MAGHOMED;
- MAGHOMEDZAKIROVICH; ABDURAKHMANOV,

14. ISLAM; SEIT-UMAROVICH; ATABIEV,
15. AKHMED; RAJAPOVICH; CHATAEV,
16. TARKHAN; ISMAILOVICH; GAZIEV,
17. ZAURBEK; SALIMOVICH; GUCHAEV,
18. SHAMIL; MAGOMEDOVICH; ISMAILOV.

b) Lista e ndryshuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”**;

1. ISAMIL; ABDALLAH; SBAITAN; SHALABI,
2. MOHAMED; GHASSAN; ALI; ABU DHESS.

C. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

c) Lista e shtuar në **“Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”**;

1. MUJAHIDIN INDONESIA TIMUR (MIT),
2. JUND AL-KHILAFAH IN ALGERIA (JAK-A).

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.